



VENDIM I AVOKATIT TË POPULLIT

Nr. OMB-C-2022-02

në lidhje me ankesën e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit kundër Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe Dhomave të Specializuara të Kosovës

Data e dorëzimit të ankesës: 26 prill 2022

Data e miratimit: 20 shkurt 2022

PUBLIK

Më 20 shkurt 2022, Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës ('Avokati i Popullit'),

Pasi mori në shqyrtim ankesën e lartpërmendur, të paraqitur në bazë të nenit 162(11) të Kushtetutës së Kosovës ('**Kushtetuta**'), nenit 34(9) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('**Ligji**') dhe rregullave 28 dhe 29 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës ('**Rregullorja**') mbi krijimin e Zyrës së Avokatit të Popullit, dhe në bazë të Procedurës së Ankesave të Zyrës së Avokatit të Popullit të miratuar nga Avokati i Popullit më 12 shtator 2018,

Pas shqyrtimit të kryer, merr këtë vendim:

I. PROCEDURA PARA AVOKATIT TË POPULLIT

1. Ankesa u regjistrua në Zyrën e Avokatit të Popullit më 26 prill 2022.
2. Në pajtim me dispozitat e pjesës 14.3 të Procedurës së Ankesave të Zyrës së Avokatit të Popullit, në trajtimin e ankesave dhe hetimeve, për hir të mbrojtjes së interesave legjitime të ankuesit ose të një pale të tretë, Zyra e Avokatit të Popullit mund ta trajtojë

si konfidencial informacionin konkret që përfshihet në një ankesë ose në një dokument apo material tjetër të marrë. Përkundër kërkesës së Avokatit të Popullit, ankuesit nuk kanë pasur kundërshtim që identitetet e tyre të bëhen të ditura dhe Avokati i Popullit ka arritur në përfundimin se nuk ekzistojnë arsye bindëse për t'i trajtuar si konfidenciale informacionet e dhëna nga ankuesit.

II. FAKTET

3. Pas shqyrtimit të korrespondencës së dorëzuar nga ankuesit, faktet mund të përmbliidhen si vijon:
4. Aktakuza fillestare kundër katër ankuesve u paraqit më 26 tetor 2020. Pas arrestimit, katër ankuesit u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës më 4 dhe 5 nëntor 2020.
5. Më 26 prill 2022, ankuesit i dorëzuan Avokatit të Popullit këtë ankesë kundër Zyrës së Prokurorit të Specializuar ('ZPS') dhe Dhomave të Specializuara të Kosovës ('DHSK'). Në bazë të rregullës 29(2)(a) të Rregullores, Avokati i Popullit nisi hetimin paraprak në lidhje me ankesën.
6. Më 7 qershor 2022, në pajtim me pjesën 7.1 të Procedurës së Ankesave, Avokati i Popullit u kërkoi ankuesve informacion shtesë në lidhje me ankesën e tyre. Kjo kërkesë nuk mori përgjigje.
7. Më 22 korrik 2022, në pajtim me pjesën 7.1 të Procedurës së Ankesave, Avokati i Popullit e përsëriti kërkesën e tij drejtuar ankuesve për dhënie të informacionit shtesë.
8. Më 24 gusht 2022, ankuesit iu përgjigjën kërkesës së Avokatit të Popullit për informacion shtesë.

III. ANKESA

9. Ankesa që iu paraqit Avokatit të Popullit, përfshirë informacionet shtesë të dhëna nga ankuesit, duket se përqendrohet në tetë pika, të cilat do të trajtohen hollësisht më poshtë. Sidoqoftë, një përmbledhje e këtyre tetë pikave është si vijon.

10. Ankuesit fillojnë duke pretenduar se DHSK-ja nuk po respekton më Kushtetutën dhe Ligjin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe më pas ngrenë një numër problemesh konkrete. (Pika A)
11. Së dyti, ankuesit pretendojnë se DHSK-ja funksionon pa asnjë mbikëqyrje, veçanërisht për faktin se nuk përgjigjet para Këshillit Gjyqësor të Kosovës. (Pika B)
12. Së treti, ata argumentojnë se DHSK-ja nuk është më pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, dhe për rrjedhojë ajo funksionon në shkelje të nenit 3(1) të Ligjit. (Pika C)
13. Së katërti, ankuesit pretendojnë se procesi po tejzgjatet. (Pika D)
14. Së pesti, ankuesit pretendojnë se ZPS-ja po vepron në kundërshtim me detyrimet e saj për nxjerrjen e materialeve. (Pika E)
15. Së gjashti, ankuesit argumentojnë se për shkak të redaktimeve të tepruara të zbatuara në materialet që u jepen, po shkelen të drejtat e tyre themelore. (Pika F)
16. Së shtati, ata ankohen për mungesën e një vendimi nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit. (Pika G)
17. Së fundi, në shtojcën e ankesës, parashtruesit e saj theksojnë se DHSK-ja gjithashtu po funksionin në kundërshtim me nenin 3(6) të Ligjit, për shkak të mungesës së një selie gjyqësore të DHSK-së në Kosovë. (Pika H)

IV. DISPOZITAT LIGJORE

18. Sipas rregullës 29(2)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Avokati i Popullit mund të kryejë hetime në lidhje me ankesa të paraqitura prej cilitdo personi që pretendon shkelje të të drejtave nga Dhomat e Specializuara ('DHS') ose nga ZPS-ja. DHS-ja dhe ZPS-ja kanë detyrimin të veprojnë në përputhje me të drejtat e mishëruara në Kushtetutë dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të parapara në të njëjtin instrument, ndër të cilat Konventa Evropiane për të Drejtat e

Njeriut ('KEDNJ')¹ dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ('KNDCP')². Këto instrumente janë të detyrueshme si për DHS-në, ashtu dhe për ZPS-në.

19. Rregulla 28(2) e Rregullores së Procedurës dhe të Provave përcakton fushëveprimin e juridiksionit të Avokatit të Popullit, i cili përfshin vetëm monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave themelore të personave që ndërveprojnë me DHS-në dhe ZPS-në.
20. Sipas nenit 162(2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ('Kushtetuta e Kosovës,' ose 'Kushtetuta')³, DHS-ja dhe ZPS-ja duhet të veprojnë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës. Në atë dispozitë konkretisht theksohet se të dy institucionet "*do të garantojnë të drejtat që i përmban Kapitulli II i Kushtetutës dhe në veçanti do të veprojnë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që janë të garantuara me Nenin 22 dhe në varshmëri me Nenin 55*".
21. Bazuar në të drejtën materiale, Avokati i Popullit ka kompetencë të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës. Rrjedhimisht, KEDNJ-ja, KNDCP-ja dhe Kushtetuta e Kosovës kanë rëndësi të veçantë për punën e Avokatit të Popullit sepse përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhen garantuar nga autoritetet publike në një shoqëri demokratike.

a. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

22. Neni 21 i Kushtetutës së Kosovës përcakton parimet e përgjithshme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe në të thuhet:

*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.
Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.*

¹ Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, ndryshuar me Protokollin nr. 11 dhe 14 (4 nëntor 1950), ('KEDNJ').

² Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ('KNDCP'), (16 dhjetor 1996), Seria e Traktateve të OKB-së Vëll. 999.

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, qershor 2008 (me ndryshimet e vitit 2020).

Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

23. Në nenin 30 të Kushtetutës, i cili i referohet të drejtave të të akuzuarit, përcaktohet se:

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

- 1. të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij/saj;*
- 2. të njoftohet menjëherë për të drejtat e saj/tij sipas ligjit;*
- 3. të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;*
- 4. të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;*
- 5. të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;*
- 6. të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet*

24. Në nenin 31 e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përcaktohet si vijon:

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*
- 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.*

6. *Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.*
7. *Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.*

25. Në nenin 32 të Kushtetutës së Kosovës, në lidhje me të drejtën për mjete juridike përcaktohet se:

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e tij/saj në mënyrën e përcaktuar me ligj.

26. Në nenin 102 të Kushtetutës së Kosovës përcaktohen parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor, si më poshtë:

1. *Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat.*
2. *Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabarta në gjykata.*
3. *Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.*
4. *Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.*
5. *Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankesë.*

27. Neni 162 i Kushtetutës së Kosovës⁴ përmban dispozitat për themelimin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, si më poshtë:

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute:

1. *Për t'i përmbushur obligimet ndërkombëtare në lidhje me Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dokumenti 12462, datë 7 janar 2011, Republika e Kosovës mund të themelojë Dhoma të Specializuara dhe një Zyre të Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës. Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni*

⁴ U shtua me Amendamentin Kushtetues 24, të botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / nr. 20 / 5 gusht 2015, Prishtinë.

- i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë .*
- 2. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar do të garantojnë të drejtat që i përmban Kapitulli II i Kushtetutës dhe në veçanti do të veprojnë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që janë të garantuara me Nenin 22 dhe në varshmëri me Nenin 55.*
 - 3. Një Dhomë e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, e përbërë nga tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë të emëruar shtesë krahas gjyqtarëve të referuar sipas Nenit 114 (1), do të vendosë ekskluzivisht mbi referimet kushtetuese sipas Nenit 113 të Kushtetutës në lidhje me Dhomat e Specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar në përputhje me ligjin e veçantë.*
 - 4. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar do të kenë zotësi të plotë ligjore dhe juridike dhe do të kenë të gjitha kompetencat e nevojshme dhe mandatin për veprim, bashkëpunim juridik, asistencë, mbrojtje të dëshmitarëve, siguri, paraburgim dhe vuajtje të dënimit jashtë territorit të Kosovës për këdo që dënohet, si dhe në lidhje me menaxhimin e ndonjë çështjeje të mbetur pas përfundimit të mandatit. Aranzhimet që dalin nga ushtrimi i këtyre kompetencave nuk i nënshtrohen Nenit 18.*
 - 5. Para hyrjes në ndonjë marrëveshje ndërkombëtare më një shtet të tretë në lidhje me bashkëpunimin juridik, që përndryshe do të kërkonte ratifikim sipas Nenit 18, Dhomat e Specializuara do të kërkojnë pajtimin paraprak të Qeverisë.*
 - 6. Dhomat e Specializuara mund t'i përcaktojnë Rregullat e veta të Procedurës dhe Provave, në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të përfshira në Nenin 22 dhe të udhëzuara nga Kodi i Procedurës Penale. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese do të rishikojë këto Rregulla për të siguruar pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.*
 - 7. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar mund të kenë seli në Kosovë dhe seli jashtë Kosovës. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar mund të ushtrojnë funksionet e tyre në të dyja selitë apo diku tjetër, sipas nevojës.*
 - 8. Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare, çdo person i akuzuar për krime nga Dhomat e Specializuara mund të paraburgoset dhe të transferohet në Dhomat e Specializuara që ndodhen jashtë territorit të Kosovës. Nëse shpallen fajtorë dhe dënohen me burgim, këta persona mund të transferohen për ta vuajtur dënimin e tyre në një shtet të tretë, jashtë territorit të Kosovës, në pajtim me marrëveshjet arritura sipas paragrafit 4.*

9. *Gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të jenë gjuha shqipe, serbe dhe ajo angleze. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar mund të vendosin mbi përdorimin zyrtar të gjuhës apo gjuhëve për ta ushtruar mandatin e tyre.*
10. *Emërimi dhe mbikëqyrja e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe mbikëqyrja dhe administrimi i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar bëhet në pajtim me ligjin e veçantë.*
11. *Do të emërohet një Ombudsperson i veçantë i Dhomave të Specializuara, me përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e Specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Funkzioni dhe obligimet e tij/saj për raportim do të përcaktohen me [ligjin e veçantë]. Nenet 133(2), 134, 135(1) dhe (2) nuk do të aplikohen ndaj Ombudspersonit të Dhomave të Specializuara. Ombudspersoni i Kosovës gjithashtu mund të referojë çështje në përputhje me Nenin 135(4).*
12. *Procedurat e veçanta administrative, modalitetet, organizimi dhe funksionimi i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorisë së Specializuar, mbikëqyrja, buxheti, auditimi dhe 3 funksionet tjera, do të rregullohen me marrëveshje ndërkombëtare, me ligjin e veçantë dhe përmes aranzhimeve sipas paragrafit 4.*
13. *Mandati i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të zgjasë për një periudhë pesëvjeçare (5), përveç nëse njoftimi i përfundimit të mandatit në pajtim me Ligjin nr. 04/L-274 bëhet më herët.*
14. *Në mungesë të njoftimit për përfundim të mandatit sipas paragrafit 12, mandati i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të vazhdojë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 04/L-274 dhe në konsultim me Qeverinë.*

b. Dispozitat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

28. *Rikujtohet se Kapitulli II i Kushtetutës thekson zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të disa instrumenteve të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë KEDNJ-në dhe KNDKP-në.*
29. *Në nenin 6 të KEDNJ-së, e drejta për proces ligjor të rregullt përcaktohet si më poshtë:*
 1. *Në kuadër të marrjes së vendimit mbi të drejtat dhe detyrimet civile, ose mbi çdo akuzë penale kundër tij, çdo person ka të drejtën për gjykim të drejtë, publik, dhe*

brenda një kohe që arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar në bazë të ligjit. Vendimi duhet të shqiptohet publikisht, por shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga ndjekja e gjithë gjykimit ose e një pjesë të tij në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet në interes të të miturve ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, ose në shkallën që, sipas mendimit të gjykatës, është absolutisht e domosdoshme në rrethana të veçanta kur publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. *Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet në bazë të ligjit.*
3. *Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*
 - a. *të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;*
 - b. *t'i jepet kohë dhe mjete e mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes;*
 - c. *të mbrojë veten ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose, në qoftë se nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar për përfaqësimin juridik, t'i mundësohet ndihmë ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;*
 - d. *Të marrë në pyetje vetë, ose të merren në pyetje në emër të tij dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të vet në kushte të njëjta si dëshmitarët e akuzës;*
 - e. *të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e përdorur në gjyq.*

30. Në nenin 13 të KEDNJ-së, e drejta për mjet juridik efektiv, përcaktohet si vijon:

Çdo person të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën për mjet juridik efektiv para autoriteteve shtetërore, pavarësisht nëse shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

31. Në nenin 2.3 të KNDCP-së thuhet:

Çdo shtet palë i kësaj Konvente zotohet:

- a. *Të sigurojë që çdo person të cilit i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, të ketë të drejtën për mjet juridik efektiv, pavarësisht nëse shkelja është kryer nga persona gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare;*

- b. *Të sigurojë që për të drejtën e çdo personi i cili kërkon mjet juridik të tillë të merret vendim nga autoritetet kompetente gjyqësore, administrative ose legjislative, ose nga çdo autoritet tjetër kompetent sipas sistemit ligjor të shtetit, si dhe të krijojë mundësi për kërkimin e mjetit juridik;*
- c. *Të sigurojë zbatimin prej autoriteteve kompetente të mjeteve juridike të miratuara.*

32. Me rëndësi është edhe neni 14 i KNDCP-së, në të cilin thuhet se:

1. *Të gjithë personat janë të barabartë para gjykatave dhe tribunalëve. Çdo person ka të drejtën e gjykimit të drejtë dhe publik para një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të krijuar sipas ligjit, që vendos lidhur me akuzat penale kundër tij, ose në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij në një çështje civile. Shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga ndjekja e gjithë procesit ose e një pjese të tij, për arsye të moralit, rendit publik, ose të sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ose kur e kërkon interesi i jetës private të palëve, ose në masën që gjykata e konsideron absolutisht të domosdoshme, në rrethana të veçanta kur publiciteti mund të dëmtojë interesat e drejtësisë; gjithsesi çdo aktgjykim i dhënë në çështjen penale ose civile duhet të bëhet publik, me përjashtim të rasteve kur interesi i të miturve e kërkon ndryshe, ose në qoftë se procesi ka të bëjë me mosmarrëveshje martesore ose me kujdestarinë e fëmijëve.*
2. *Çdo person i akuzuar për një veprë penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet në përputhje me ligjin.*
3. *Në marrjen e vendimit lidhur me akuzat penale kundër tij, çdo person i akuzuar për një veprë penale ka të drejtën e këtyre garancive minimale, në kushte barazie të plotë:*
 - a. *Të informohet menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme, në një gjuhë të cilën e kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;*
 - b. *Të ketë kohë dhe mjete e mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe të komunikojë me një avokat të zgjedhur prej tij;*
 - c. *Të gjykohet pa vonesë të papërligjur;*
 - d. *Të jetë i pranishëm gjatë procesit dhe të mbrohet vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; në qoftë se nuk ka përfaqësim juridik, të informohet për këtë të drejtë; dhe, kurdoherë që e kërkon interesi i drejtësisë t'i caktohet përfaqësim juridik pa pagesë nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar;*

- e. Të marrë në pyetje vetë, ose të merren në pyetje në emër të tij, dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të vet në kushte të njëjta si dëshmitarët e akuzës;
 - f. Të ketë ndihmën falas të një përkthyesi në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën që përdoret në gjykim;
 - g. Të mos shtrëngohet të dëshmojë kundër vetes ose të pranojë fajësinë.
4. Procedura që zbatohet për të miturit duhet të jetë e tillë që të marrë parasysh moshën e tyre dhe interesin e mbështetjes së riedukimit të tyre.
 5. Çdo person i shpallur fajtor për një veprë penale ka të drejtë të kërkojë shqyrtimin e vendimit të fajësisë dhe të dënimit nga një instancë gjyqësore më e lartë, në përputhje me ligjin.
 6. Kur personi ka marrë vendim fajësie të formës së prerë për një veprë penale dhe kur në vijim vendimi i fajësisë është prapësuar ose ai është falur për arsye se një fakt i ri ose një fakt i zbuluar rishtas provon në mënyrë përfundimtare se është bërë gabim ligjor, personi që është ndëshkuar si rezultat i këtij vendimi fajësie dëmshpërblehet në bazë të ligjit, përveç nëse provohet se mosnxjerrja në kohë e faktit të panjohur është shkaktuar plotësisht ose pjesërisht prej tij.
 7. Askush nuk mund të ndiqet ose të ndëshkohet sërish për një veprë penale për të cilën ai ka marrë tashmë një vendim fajësie ose pafajësie të formës së prerë në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të çdo vendi.

V. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE KONKRETE TË PARAQITURA NGA ANKUESIT

A – Pretendimet konkrete të ankuesve në lidhje me respektimin e Kushtetutës dhe Ligjit nga DHSK-ja

PRETENDIMI

33. Ankuesit pretendojnë se DHSK-ja nuk po i respekton më dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës e në veçanti nenin 102(3) të Kushtetutës dhe se, si rezultat, DHSK-ja është shndërruar plotësisht në një gjykatë ndërkombëtare; për pasojë, cilido person ndaj të cilit ngrihen akuza në DHSK, rrezikon të akuzohet ose të dënohet pa bazë ligjore dhe të diskriminohet. Ata mbështeten konkretisht në sa vijon:
34. Dhomat e Specializuara refuzuan të zbatojnë legjislacionin penal që ishte në fuqi në Kosovë ndërmjet janarit 1998 dhe dhjetorit 2000;

35. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese (DHSGJK) në vendimet e saj KSC-CC-2022-13 dhe 14, gaboi që zbatoi versionin në serbishte të Kushtetutës në lidhje me përdorimin e fjalës “i akuzuar” ose “i dënuar”, në vend që të zbatonte versionin në anglishte dhe shqipe të tekstit;
36. DHSGJK-ja, në vendimin e saj KSC-CC-2022-15, gaboi që e konsideroi hetimin në lidhje me trafikimin e paligjshëm të organeve si vetëm një nga arsyet për themelimin e gjykatës;
37. Të drejtat e tyre themelore u shkelën si pasojë e tërheqjes së gjykatësit Kai Ambos nga Paneli i Gjykatës së Apelit që u caktua për të shqyrtuar apelin e z. Thaçi lidhur me lirim të përkohshëm;
38. Parashtrimet e policisë së Kosovës në lidhje me monitorimin e arrestit shtëpiak në Kosovë dhe garancitë e shteteve të treta në lidhje me lirim të përkohshëm të të akuzuarve në Kosovë ose në territorin e shteteve të treta, nuk u pranuan;
39. Ankuesit ngrenë pretendim për shkelje të konfidencialitetit të komunikimit mbrojtës-klient, për shkak të kontrollimit të kompjuterave të të akuzuarve dhe fshirjen e dokumenteve pa njoftim paraprak dhe në mungesë të tyre dhe të Mbrojtësve të tyre.
40. Ndonëse ankuesit pranojnë se në përputhje me Rregulloren, kjo pjesë e ankesës mund të konsiderohet se lidhet me debatet juridike para Dhomave të Specializuara, ata parashtrojnë se edhe Avokati i Popullit duhet të ketë juridiksion për dy arsye:
41. Kërkesa ka të bëjë me zbatimin e drejtë të Kushtetutës dhe jo me bazën e akuzave kundër tyre, dhe DHSGJK-ja e rrëzoi si të papranueshme kërkesën e tyre në lidhje me dispozitat ligjore të zbatueshme, dhe nuk shqyrtoi themelësinë e kërkesës së tyre, ose së paku thelbin e pretendimit të tyre se po diskriminoheshin;
42. Kjo çështje ka rëndësi të madhe dhe ekziston rrezik real i shkeljes së të drejtave të tyre kushtetuese, gjë që kërkon ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, veçanërisht pasi jashtë mureve të Dhomave të Specializuara nuk ekzistojnë mekanizma të tjerë mbrojtës.

VLERËSIMI

43. Siç theksohet në Ankesë nga parashtruesit e saj, problemet që ata ngrenë i janë paraqitur edhe më parë gjykatës gjatë konferencave të ndryshme mbi ecurinë e çështjes, rishikimeve të shumta të paraburgimit dhe gjithashtu kanë qenë objekt i vendimeve të Gjykatës Themelore të Dhomave të Specializuara dhe të DHSGJK-së, në çështjet KSC-BC-2020-06, KSC-CC-2022-14 dhe KSC-CC-2022-15. Si rezultat, këto aspekte janë pjesë e procesit para Dhomave të Specializuara dhe, për rrjedhojë, sipas rregullës 29(1) dhe 29(3)(a) të Rregullores, nuk përfshihen në juridiksionin e Avokatit të Popullit.
44. Sa u përket argumenteve të ankuesve lidhur me juridiksionin e Avokatit të Popullit, Rregullorja është shumë e qartë në lidhje me juridiksionin e tij mbi proceset gjyqësore që zhvillohen në gjykatë dhe përjashtimet e përmendura nga ankuesit nuk janë të parapara me Rregullore.
45. Sidoqoftë, ankuesit kanë pasur dhe ende kanë në dispozicion mjete juridike për shqyrtimin e pretendimit konkret të lartpërmendur në lidhje me shkeljen e të drejtave themelore të tyre, siç është referimi në DHSGJK. Lidhur me të drejtën për mjet juridik efektiv, duhet theksuar se fjala “mjet juridik”, në kontekstin e nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (‘KEDNJ’), nuk nënkupton një mjet juridik që detyrimisht do të ketë sukses, por thjesht një mjet juridik që mund të përdoret para një autoriteti kompetent për të shqyrtuar themelësinë e një ankese⁵. Neni 13 garanton disponueshmërinë e mjetit juridik por jo një rezultat të suksesshëm⁶. Mundësitë e pakta për sukses, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të çështjes, nuk e zvogëlojnë “efektivitetin” e mjetit juridik të parashikuar në nenin 13.⁷
46. Gjithashtu, fakti se vendimi i instancës më të lartë gjyqësore nuk është objekt rishikimi gjyqësor të mëtejshëm, nuk është në vetvete shkelje e nenit 13 dhe as përbën një ankesë të argumentueshme sipas Konventës⁸. Kur akti i kundërshtuar buron nga gjykata apo instanca më e lartë shtetërore, zbatimi i nenit 13 kufizohet në mënyrë të nënkuptuar, pasi ai nuk përcakton mjet juridik për apelim të mëtejshëm.⁹ Në çështjen *Wendenburg and Others v. Germany*¹⁰, mungesa e mjetit juridik kundër një vendimi të Gjykatës Kushtetuese nuk ngriti ndonjë pikë të apelueshme sipas nenit 13, dhe

⁵ *C. v. the United Kingdom*, vendim i Komisionit, 1983

⁶ *R. v. the United Kingdom*, vendim i Komisionit, 1984

⁷ *Murray v. the United Kingdom*, 1994, § 100

⁸ *Tregubenko v. Ukraine* (dec.), 2003; *Sitkov v. Russia* (dec.), 2004; *Yuriy Romanov v. Russia*, 2005, § 55

⁹ *Crociani and Others v. Italy*, vendimi Komisionit, 1980, f. 150 dhe 183, në lidhje me Gjykatën Kushtetuese; *Verein Alternatives Lokalradio Bern and Verein Radio Dreyeckland Basel v. Switzerland*, vendim i Komisionit, 1986, në lidhje me Këshillin Federal, autoriteti më i lartë administrativ; *Times Newspapers Ltd and Andrew Neil v. the United Kingdom*, raport i Komisionit, 1991, § 60, në lidhje me Dhomën e Lordëve.

¹⁰ *Wendenburg and Others v. Germany* (dec.), 2003

gjykata e shpalli të papranueshme atë pjesë të kërkesës si qartësisht të pabazuar. Rrjedhimisht, dispozitat e Konventës nuk mund të interpretohen si dispozita që detyrojnë shtetet të krijojnë organe për të mbikëqyrur gjyqësorin ose shërbimin juridik të shtetit.¹¹

47. Avokati i Popullit nuk mund të marrë rolin e instancës ku drejtohen apelet ndaj vendimeve të gjykatës, që është në thelb ajo që po kërkojnë ankuesit. DHSK-ja funksionon brenda një kornize ligjore specifike të përcaktuar nga Kuvendi dhe në përputhje me Kushtetutën, dispozitat ligjore të zbatueshme dhe Rregulloren. Avokati i Popullit nuk ka juridiksion të shqyrtojë zbatimin nga gjykatat të kornizës ligjore në fuqi.
48. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit rrëzon këtë element të ankesës, pasi sipas rregullës 29(1) të Rregullores, ai nuk ka juridiksion për shqyrtimin e saj.

B – Mungesa e mbikëqyrjes demokratike / mungesa e llogaridhënies para Këshillit Gjyqësor të Kosovës

PRETENDIMI

49. Ankuesit pretendojnë se ka mungesë të mbikëqyrjes demokratike mbi Gjykatën. Në këtë aspekt, ankuesit pretendojnë se ka mungesë të plotë të llogaridhënies nga ana e Dhomave të Specializuara, veçanërisht në mungesë të llogaridhënies para Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ata pretendojnë se kjo mungesë llogaridhënieje është përforcuar nga shkëputja e Dhomave të Specializuara prej sistemit gjyqësor të Kosovës dhe pavarësia e plotë e tyre prej tij.

VLERËSIMI

50. Avokati i Popullit rikujton se pavarësia e DHSK-së nga sistemi gjyqësor i Kosovës dhe kushtetutshmëria e saj janë shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe janë vlerësuar si kushtetuese. Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

¹¹ *Pizzetti v. Italy*, raport i Komisionit, 1991, § 41

“...metodat e funksionimit të Dhomave të Specializuara janë brenda kornizës së sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës... Struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe funksionimi i Dhomave të Specializuara do të rregullohen me ligje të tjera, në pajtim me Kushtetutën. Rrjedhimisht, Dhomat e Specializuara nuk pakësojnë të drejtat kushtetuese të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës si dhe në Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.”¹²

51. DHSK-ja funksionin në përputhje me kornizën ligjore të veçantë të miratuar nga Kuvendi dhe i përmbahet Kushtetutës,¹³ dispozitave ligjore të zbatueshme¹⁴ dhe Rregullores.¹⁵
52. Në Kushtetutë dhe në dispozitat ligjore të zbatueshme është përcaktuar që Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka juridiksion mbi punën e DHSK-së. Në këtë aspekt, neni 162(10) i Kushtetutës thotë shprehimisht se emërimi dhe mbikëqyrja e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe mbikëqyrja dhe administrimi i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar bëhet në pajtim me ligjin e veçantë.¹⁶
53. Avokati i Popullit vë në dukje se në kuadër të Dhomave të Specializuara, janë krijuar mekanizmat e duhur të llogaridhënies.¹⁷
54. Avokati i Popullit rikujton se gjykatësit e DHSK-së kanë miratuar Kodin e Etikës Gjyqësore për Gjykatësit e Emëruar në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, që rregullon mënyrën e sjelljes të të gjithë gjykatësve të emëruar në DHSK.¹⁸ Kodi i Etikës ofron një mekanizëm për paraqitjen e ankesave nga për çdo person që pretendon se i janë cenuar në masë të konsiderueshme të drejtat ose interesat nga sjellja kundërvajtëse e pretenduar e një gjykatësi të DHSK-së.
55. Gjithashtu, Administratorja, me aprovimin e Kryetares, ka miratuar Kodin e Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të

¹² Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i 15 prillit 2015, Rasti nr. K026/15, para. 58,59.

¹³ KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, ndryshuar me Amendamentin nr. 24, (Neni 162- Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar), 3 gusht 2015.

¹⁴ Ligji nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 2015.

¹⁵ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (miratuar më 17 mars 2017, rishikuar më 29 maj 2017, ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020).

¹⁶ Konkretisht nenet 27, 28, 30, 31, 35 të Ligjit, të cituar më lart n 10.

¹⁷ Shih për shembull, nenet 31(4), 48(1), 48(2) a, b dhe 49(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015, ku parashikohen mekanizma të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies në kuadër të strukturës së Dhomave të Specializuara.

¹⁸ Miratuar më 14 mars 2017, në bazë të nenit 19(6) të Ligjit dhe në pajtim me nenin 31(4) të Ligjit.

Kosovës.¹⁹ Ky Kod i Etikës ofron një mekanizëm për parashtrimin e ankesave nga çdo person që pretendon se ndaj tij/saj është kryer një sjellje kundërvajtëse nga mbrojtësit ose prokurorët.

56. Avokati i Popullit gjithashtu rikujton se gjykatësit e DHSK-së, miratuan në seancë plenare Rregulloren për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë, që rregullon caktimin e gjykatësve në trupa gjykues dhe panele për procedura gjyqësore konkrete. Kjo Rregullore përcakton qartë parimet dhe kriteret e caktimit të gjykatësve. Publiku vihet në dijeni për çdo gjykatës të caktuar nga Kryetarja.
57. Avokati i Popullit është i mendimit se ankuesit nuk kanë arritur të provojnë se mungesa e llogaridhënies ndaj Këshillit Gjyqësor të Kosovës ose e mbikëqyrjes prej tij, ka shkaktuar në ndonjë mënyrë shkeljen e të drejtës së tyre themelore për gjykim të drejtë dhe, në bazë të rregullës 29(3)(b) të Rregullores, rrezon këtë element të ankesës.

C – Mosrespektimi i nenit 3(1) të Ligjit nr. 05/L-053

PRETENDIMI

58. Ankuesit pretendojnë se DHSK-ja nuk po i respekton më dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, dhe në veçanti, nenin 3(1) të Ligjit në të cilin thuhet se:

“Dhomat e Specializuara janë pjesë përbërëse e çdo niveli të sistemit të gjykatave në Kosovë: Gjykatës Themelore të Prishtinës, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Supreme do të merret ekskluzivisht me referimet kushtetuese lidhur me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar”.

59. Konkretisht, ata pretendojnë se Dhomat e Specializuara tashmë janë një gjykatë ndërkombëtare e jo gjykatë vendore, dhe, për pasojë, cilido person ndaj të cilit ngrihen akuza në DHSK, rrezikon të akuzohet ose të dënohet pa bazë ligjore dhe të diskriminohet.

¹⁹ Miratuar më 28 prill 2021, në përputhje me nenin 34(3) të Ligjit dhe rregullën 23(3) të Rregullores.

VLERËSIMI

60. Ndërsa në versionin në anglishte të Ligjit thuhet se *“Dhomat e Specializuara përfaqësojnë çdo nivel të sistemit të gjykatave në Kosovë”*, në versionin në gjuhën shqipe të Ligjit thuhet se Dhomat e Specializuara **janë pjesë përbërëse** e çdo niveli të sistemit të gjykatave në Kosovë,²⁰ dhe në versionin në gjuhën serbe të tekstit thuhet se Dhomat e Specializuara **themelohen** në çdo nivel të sistemit gjyqësor në Kosovë.²¹
61. Si pasojë, mund të duket se ka njëfarë mospërputhjeje në kriteret e nenit 3(1) të Ligjit në të tri gjuhët. Rrjedhimisht, është e domosdoshme që ky kriter të interpretohet në përputhje me kontekstin e brendshëm dhe të jashtëm të kësaj dispozite dhe me synimin e qëllimin e saj.
62. Së pari, në nenin 1(2) të Ligjit thuhet se Ligji synon përmbushjen e *“obligimeve ndërkombëtare të parapara në Ligjin nr. 04/L-274”*, i cili parasheh ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë [**Shkëmbimi i Letrave**]. Nga Shkëmbimi i Letrave është e qartë se DHSK-ja do të funksiononte si një dhomë **e veçantë** gjyqësore,²² një aspekt procedural i punës së DHSK-së ky që është miratuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.²³
63. Në fakt, nga formulimi i Shkëmbimit të Letrave është e qartë se ndonëse Gjykata Speciale do të krijohej **brenda** sistemit gjyqësor të Kosovës, për të mundësuar funksionimin e këtyre procedurave, Kosova do të themelonte dhoma **të veçanta** e të dedikuara gjyqësore, të cilat do të **përfshinin** të gjitha instancat e sistemit gjyqësor, duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese.
64. Rrjedhimisht, meqenëse Ligji duhet të materializojë Shkëmbimin e Letrave, është e qartë se nuk është e nevojshme që DHSK-ja fizikisht *“të përfaqësojë çdo nivel të sistemit të gjykatave në Kosovë”*. Ndonëse DHSK-ja duhet **të përfshijë** të gjitha nivelet e sistemit të gjykatave të Kosovës, ajo duhet të mbetet e ndarë prej tyre.

²⁰ Në versionin në gjuhën shqipe të tekstit thuhet: “Dhomat e specializuara janë pjesë përbërëse e çdo niveli të sistemit të gjykatave në Kosovë: Gjykatës Themelore të Prishtinës, Gjykatës së Apelit”.

²¹ Në versionin në gjuhën serbe të tekstit thuhet: *“Specijalizovana veća se osnivaju pri svakom nivou sudskog sistema na Kosovu”*.

²² Ligji nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (‘Shkëmbimi i Letrave’), 14 prill 2014, f.3, “Për të mundësuar funksionimin e procedurave të tilla, Kosova do të themelojë dhoma të veçanta e të dedikuara gjyqësore, të cilat do të zhvendosen në një shtet të tretë, në bazë të një marrëveshjeje me atë shtet, dhe të cilat do të përfshinin të gjitha instancat e sistemit gjyqësor, duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese, për çfarëdo procedure penale e cila mund të iniciohet si rezultat i punës së SITF. ”

²³ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i 15 prillit 2015, Rasti nr. K026/15.

65. Avokati i Popullit është i mendimit se ankuesit nuk kanë dhënë asnjë provë se DHSK-ja nuk po i respekton më dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, dhe në veçanti nenin 3(1) të Ligjit, dhe e gjykon të pathemeltë pretendimin e paraqitur nga ankuesit.
66. Gjithashtu, Avokati i Popullit është i mendimit se ankuesit nuk kanë provuar se zbatimi i nenit 3(1) të Ligjit ka sjellë në ndonjë mënyrë si pasojë shkeljen e të drejtës së tyre themelore për gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit rrëzon këtë element të ankesës në bazë të rregullës 29(3)(b) të Rregullores.

D – Tejzgjatja e procesit

PRETENDIMI

67. Ankuesit pretendojnë se po përballen me një tejzgjatje të procesit, veçanërisht pasi fillimisht u njoftua se ZPS-ja do të ishte gati të fillonte gjykimin në verën e vitit 2021, por edhe për shkak të shtyrjes së nxjerrjes së provave shfajësuese dhe zgjatjeve të shumta të afateve që janë miratuar për ZPS-në;

VLERËSIMI

68. Avokati i Popullit thekson se problemet që ngrenë ankuesit në kuadër të këtij elementi të ankesës tashmë kanë qenë objekt i diskutimeve dhe kuvendimeve para Gjykatës Themelore të DHSK-së dhe DHSGJK-së, për shembull në rastin e vendimeve në çështjet KSC-BC-2020-06 dhe KSC-CC-2022-14 e KSC-CC-2022-15. Sidoqoftë, ankesa konkrete që në këtë rast i është paraqitur Avokatit të Popullit është se ka vonesa të panevojshme në këto çështje.
69. Në rregullën 29(1) të Rregullores përcaktohet se *“Avokati i Popullit nuk ndërhyt në çështje gjyqësore ose procese të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara, me përjashtim të rasteve në lidhje me vonesa të paarsyeshme. [...]”*.
70. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit duhet ta trajtojë këtë element të ankesës në kontekstin e kompetencave të tij, të parashikuara në rregullën 29(1) të Rregullores.
71. Ndonëse zakonisht fjala “ndërhyt” nënkupton se Avokati i Popullit mund të kontribuojë drejtpërdrejt në procese dhe çështje para Dhomave të Specializuara, ai,

duke analizuar këtë dispozitë, mban parasysh doktrinën e ndarjes së pushteteve, pavarësinë e gjyqësorit dhe rolin e Avokatit të Popullit.

72. Normalisht, Avokati i Popullit, si mbrojtës i pavarur i të drejtave të njeriut, nuk duhet të ndërhyjë në institucionet e tjera të pavarura. Në veçanti, Avokati i Popullit nuk duhet të konkurrojë me mbrojtjen juridike që ofrojnë gjykatat. Të dy konceptet kanë një qëllim të përbashkët – mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por bazohen në koncepte krejtësisht të ndryshme organizative dhe funksionale. Avokati i Popullit ka kompetenca rekomanduese për parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe avancimin e mbrojtjes së këtyre të drejtave, ndërsa gjykatat duhet të vendosin për raste individuale dhe mund të urdhërojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
73. Rrjedhimisht, pavarësia e të dy institucioneve dhe parimi i ndarjes së pushteteve kërkojnë një ndarje të qartë të këtyre dy institucioneve dhe përjashtojnë kontrollin e ndërsjellë.
74. Avokati i Popullit rikujton vlerësimin e Komisionit të Venecias në lidhje me çdo dispozitë që i jep Avokatit të Popullit kompetencë të ndërhyjë në procese gjyqësore. Në Mendimin e Komisionit të Venecias lidhur me projektligjin për Avokatin e Popullit të Kosovës, thuhet:

“Në përgjithësi, do të ishte më mirë që Avokatit të Popullit t’i jepej kompetenca për të dhënë rekomandime të përgjithshme lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe të përjashtojë kompetenca për të ndërhyrë në çështje individuale (madje as për sa i përket kohëzgjatjes së tyre); kjo duhet t’i lihet vetë gjyqësorit. Në nenin 30, paragrafi 1(e) të projektligjit, përcaktohet se Avokati i Popullit ka gjithashtu kompetencë të hetojë ankesat ndaj gjyqësorit, por me kusht që kjo të mos sjellë ndërhyrje në procedurën e zhvilluar nga gjykata. Sidoqoftë, është e vështirë të mendohet se si një ankesë për shkeljen nga gjykata të një dispozite të të drejtave të njeriut (përfshirë ato që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procesit) të mos jetë pjesë e procedurës gjyqësore.”²⁴

75. Duke pasur parasysh këtë, Avokati i Popullit është i mendimit se dispozitat e rregullës 29(1) duhet të interpretohen me përpikëri dhe duhet të kufizohen në shqyrtimin dhe dhënien e rekomandimeve të përgjithshme (kur është e përshtatshme) për funksionimin e sistemit gjyqësor, dhe jo në hetimin e ankesave ndaj gjyqësorit kur në këto ankesa pretendohet shkelja nga gjykata e dispozitave të të

²⁴ EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION) OPINION ON THE DRAFT LAW ON THE PEOPLE’S ADVOCATE OF KOSOVO, miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e 71-të plenare të tij (Venecia, 1-2 qershor 2007), Opinion no. 434/2007.

drejtave të njeriut (përfshirë ato që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procesit), çka do të ishte pjesë e procedurës gjyqësore.

76. Avokati i Popullit rikujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('GJEDNJ') ka konstatuar në mënyrë të përsëritur se sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së shtetet palë të kësaj Konvente kanë detyrimin që t'i organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund të përmbushin secilin prej kriterëve të tij, ndër to dhe detyrimin për gjykimin e çështjeve brenda një kohe të arsyeshme.²⁵
77. Në këtë aspekt, Avokati i Popullit thekson se Ligji përcakton dhe rregullon organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e DHSK-së dhe ZPS-së dhe se DHSK-ja dhe ZPS-ja kanë personalitet ligjor dhe juridik të plotë.
78. Në organizimin e efikasitetit procedural dhe aspekteve administrative të sistemit të saj gjyqësor, DHSK-ja ka për detyrë të sigurojë zbatimin e proceseve dhe procedurave përkatëse për të mundësuar zhvillimin e proceseve në tri gjuhët zyrtare, zhvillimin e tyre në shtetin pritës, si dhe të përcaktojë një mori masash dhe procedurash të tjera të cilat zakonisht, nuk kërkohen dhe nuk janë të nevojshme për gjykatat përkatëse në Kosovë.
79. Gjatë analizës nëse DHSK-ja i ka përmbushur kriteret e nenit 6(1), sikurse shtjellohet në aktgjykimin në çështjen *Gast and Popp v. Germany*,²⁶ Avokati i Popullit vëren se që nga krijimi i saj, gjykata e ka kryer vazhdimisht punën e saj në mënyrë të shpejtë, pavarësisht se është përballur me shumë sfida, ndër të cilat pandemia KOVID 19. Në këtë aspekt, Avokati i Popullit mban parasysh faktin se gjykata vazhdoi të funksiononte në mënyrë të plotë gjatë gjithë periudhës së pandemisë dhe vazhdoi punën me proceset e saj.
80. Në rastin e Çështjes nr. KSC-BC-2020-06, të akuzuarit u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë më 4 dhe 5 nëntor 2020. Katër të akuzuarit patën paraqitjen e tyre të parë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake në datat ndërmjet 9 dhe 11 nëntorit 2020. Më 15 dhjetor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi çështjen Trupit Gjykues. Trupi Gjykues mbajti konferencën e parë për ecurinë e çështjes të nesërmen, më 16 dhjetor 2022. Konferenca përgatitore për gjykimin u mbajt më 18 janar 2023. Gjykimi është caktuar të fillojë më 3 prill 2023.

²⁵ *Gast and Popp v. Germany (Application no. 29357/95), Judgment, 25 February 2000, para.75.*

²⁶ Po aty.

81. Krahas kësaj, në parashtrimin e datës 14 shkurt 2023, Prokuroria informoi se ka ndër mend të kërkojë të pranohen 312 dëshmitarë dhe vlerësoi se për të paraqitur provat e saj do t'i duheshin 545.5 orë. Sipas parashtrimit të Prokurorisë, kjo përbën një pakësim me 24% të numrit të orëve, krahasuar me përlllogaritjen e orëve që u paraqit më 2 nëntor 2022. ZPS-ja e bëri këtë vlerësim bazuar në informacionin aktual dhe duke mbajtur parasysh se ky vlerësim është paraprak. Paraqitja e provave të Prokurorisë mund të përfundojë në fund të vitit 2024, por mund të vazhdojë edhe në vitin 2025, varësisht prej shumë faktorëve.²⁷
82. Avokati i Popullit është i mendimit se nuk ka prova që të çojnë në përfundimin se aspektet procedurale dhe administrative të DHSK-së kanë mangësi dhe nuk mbështesin proceset që po zhvillohen kundër ankuesve.
83. Në mbështetje të kësaj pikëpamjeje, Avokati i Popullit rikujton se të gjitha proceset e tjera para DHSK-së janë zhvilluar dhe po zhvillohen në mënyrë efikase dhe po ecin me shpejtësi.²⁸
84. Avokati i Popullit është i vetëdijshëm se secili prej këtyre proceseve paraqet nivel të ndryshëm vështirësie dhe duhet pranuar se procesi gjyqësor që po zhvillohet kundër ankuesve është i ndërlikuar.²⁹
85. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit konstaton se nuk ka prova për vonesë të panevojshme nga ana e DHSK-së në organizimin e aspekteve procedurale dhe

²⁷ KSC-BC-2020-06/F01291, Parashtrim i Prokurorisë përpara Mbajtjes së Konferencës Përgatitore për Prokurorin e Specializuar me Shtojcat Konfidenciale 1-3 dhe Shtojcat Rreptësisht Konfidenciale dhe Ex Parte 4-6, para. 6-11.

²⁸ Në Çështjen nr. KSC-BC-2020-05, i akuzuari u arrestua më 24 shtator 2020. Më 28 shtator 2020 ai pati paraqitjen e tij të parë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Më 7 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes Trupit Gjykues I. Gjykimi i tij filloi më 15 shtator 2021 dhe deklaratat përmbyllëse u bënë nga 13 deri më 15 shtator 2022. Aktgjykimi u shqiptua më 16 dhjetor 2022.

Në Çështjen nr. KSC-BC-2020-07/KSC-CA-2022-01, të akuzuarit u arrestuan më 25 shtator 2020. Më 18 dhjetor 2020, ata patën paraqitjen e tyre të parë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Më 16 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes Trupit Gjykues II. Gjykimi i tyre filloi më 7 tetor 2021 dhe deklaratat përmbyllëse u bënë nga 14 deri më 17 mars 2022. Aktgjykimi u shqiptua më 18 maj 2022. Njoftimi për apel u dorëzua nga Mbrojtja më 17 qershor 2022 dhe seanca e apelit u mbajt më 1 dhe 2 dhjetor 2022.

Në Çështjen nr. KSC-BC-2020-04, i akuzuari u arrestua më 16 mars 2021 dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së më 15 prill 2021. Më 19 prill 2021, ai pati paraqitjen e parë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Më 21 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes Trupit Gjykues I. Konferenca përgatitore për gjykimin u mbaj ndërmjet 18 dhe 20 tetorit 2022.

²⁹ Deri më 20 janar 2023, në këtë çështje gjyqësore ishin mbajtur 26 seanca, 16 prej të cilave gjatë kohës që gjykata funksiononte nën kufizimet për shkak të pandemisë COVID 19. Pavarësisht vështirësive që krijuan këto kufizime, gjykata vendosi një lidhje të posaçme me video për të siguruar që të akuzuarit të mund të merrnin pjesë aktive në proces gjatë gjithë kohës. Gjykata u mundësoi edhe mbrojtësve të merrnin pjesë në seanca përmes videolidhjes.

Avokati i Popullit vëren se deri më tani gjykata nuk ka anuluar asnjë seancë të caktuar për t'u mbajtur në këtë çështje gjyqësore. Gjatë kësaj kohe, gjykata ka administruar 10109 faqe dokumentacion nga 1215 parashtrime të protokolluara, ndër të cilat kërkesa, parashtrime, dhe urdhra, si dhe 25 apele të ndërmjetme dhe një apel drejtuar Gjykatës Kushtetuese në lidhje me mbrojtjen e ligjshmërisë.

administrative të sistemit të saj gjyqësor, në mbështetje të ë procesit gjyqësor kundër ankuesve dhe në bazë të rregullës 29(3)(b) të Rregullores, rrëzon këtë element të ankesës.

E – Mospërmbushja nga ZPS-ja e detyrimeve për nxjerrjen e materialeve

PRETENDIMI

86. Ankuesit pretendojnë se ZPS-ja nuk po i përmbush detyrimet e saj për nxjerrjen e materialeve dhe ende nuk ka nxjerrë materialet e rregullave 102(3) dhe 103.

VLERËSIMI

87. Aspektet lidhur me pretendimet për mospërmbushje të detyrimeve për nxjerrjen e materialeve tashmë janë paraqitur para gjykatës gjatë konferencave të ndryshme mbi ecurinë e çështjes dhe Gjykata Themelore e DHSK-së ka dhënë vendime për to. Për rrjedhojë, këto aspekte janë pjesë e procesit para Dhomave të Specializuara.

88. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit duhet ta rrëzojë këtë element të ankesës pasi, sipas rregullave 29(1) dhe 29(3)(a) të Rregullores, ai është jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit.

F – Redaktimet e tepruara në materialet që u janë dhënë

PRETENDIMI

89. Ankuesit pretendojnë se në dokumentacionin që kanë marrë nga ZPS-ja janë bërë redaktime të tepruara.

VLERËSIMI

90. Problemi i redaktimeve të tepruara të zbatuara nga prokuroria tashmë i është paraqitur gjykatës gjatë konferencave të ndryshme mbi ecurinë e çështjes, dhe ka qenë edhe objekt i vendimeve të Gjykatës Themelore të DHSK-së. Rrjedhimisht, ky element është pjesë e procesit para Dhomave të Specializuara dhe Avokati i Popullit duhet ta rrëzojë pasi, sipas rregullave 29(1) dhe 29(3)(a) të Rregullores, ai është jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit.

G – Mungesa e një vendimi lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit

PRETENDIMI

91. Ankuesit pretendojnë se propozimi aktual i prokurorisë në lidhje me numrin e dëshmitarëve dhe të orëve të seancave gjyqësore do të bënte që gjykimi të zgjaste dhjetë vjet dhe, gjithsesi, ata ankohen se nuk është dhënë përgjigje e qartë nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të marrë vendim lidhur me këtë propozim.

VLERËSIMI

92. Ky pretendim ka qenë objekt i debateve dhe kuvendimeve para Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Gjithashtu, Avokati i Popullit thekson sërish se të mërkurën, më 30 nëntor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake njoftoi Kryetaren e DHSK-së se dosja e çështjes gjyqësore kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit do të ishte gati për t’iu kaluar Trupit Gjykues më 15 dhjetor të atij viti.

93. Në përputhje me këtë, Kryetarja e DHSK-së caktoi Trupin Gjykues II për gjykimin e kësaj çështjeje, më 18 janar 2023 u mbajt konferenca përgatitore për gjykimin dhe gjykimi është caktuar të fillojë më 3 prill 2023.

94. Rrjedhimisht, ky aspekt është pjesë e procesit para Dhomave të Specializuara dhe duhet të rrëzohet pasi, sipas rregullave 29(1) dhe 29(3)(a) të Rregullores, ai është jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit.

H – Mungesa e një selie gjyqësore në Kosovë

PRETENDIMI

95. Në shtojcën e Ankesës, ankuesit pretendojnë se DHSK-ja funksionon në shkelje të nenit 3(6) të Ligjit, në të cilin thuhet se

“Dhomat e Specializuara janë një seli në Kosovë. Siç përcaktohet me anë të një marrëveshjeje ndërkombëtare me shtetin pranues, Dhomat e Specializuara po ashtu kanë seli edhe në shtetin pranues jashtë Kosovës, por në raste të

jashtëzakonshme mund të mblidhen edhe gjetiu, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për interesat e administrimit të duhur të drejtësisë. [...].”

VLERËSIMI

96. Avokati i Popullit rikujton se, përveç dispozitës së nenit 3(6) të Ligjit, neni 3(8)(a) përcakton se:

“Kryetari i Dhomave të Specializuara, Prokurori i Specializuar, Mbrojtësi i Specializuar ose Mbrojtësi i Viktimave munden, sipas diskrecionit të tyre, të kërkojnë që të bëhet ndryshimi i vendit tek shteti pranues për shqyrtimin gjyqësor, cilëndo pjesë të shqyrtimit gjyqësor, ose ndonjë fazë apo disa fazave të caktuara të procedurës penale sipas këtij Ligji;”.

97. Lidhur me procesin kundër katër parashtruesve të ankesës, Kryetarja kërkoi caktimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës, gjë që çoi në vendimin KSC-BC-2020-06/F00017 të 21 shtatorit 2020. Kjo kërkesë për caktimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës tregon se selia e DHSK-së u zhvendos nga Kosova si edhe se, nëse nuk do të ishte marrë ai vendim, DHSK-ja do të kishte pasur mundësinë t’i zhvillonte procedurat e saj në selinë e saj në Kosovë.

98. Avokati i Popullit është i mendimit se ankuesit nuk kanë arritur të provojnë se zbatimi i nenit 3(6) të Ligjit ka sjellë në ndonjë mënyrë si pasojë shkeljen e të drejtës së tyre themelore për gjykim të drejtë, që mbrohet nga Kapitulli II i Kushtetutës së Kosovës. Çdo parashtrim që argumenton se sipas nenit 3(6) të Ligjit DHSK-ja duhet të ketë një seli të përhershme fizike në Kosovë, rrëzohet si i pabazë. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit, rrëzon këtë element të ankesës në bazë të rregullës 29(3)(b) të Rregullores.

VI. PËRFUNDIM

99. Avokati i Popullit arrin në përfundimin se Pikat A, E, F dhe G të ankesës që kanë të bëjnë, përkatësisht, me pretendimet për mosrespektimin e Kushtetutës dhe Ligjit, mospërbushjen e detyrimeve për nxjerrjen e materialeve, redaktimet e tepruara të zbatuara në materialin shfajësues, dhe mungesën e një vendimi lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit, janë objekt i shqyrtimit nga gjykata dhe, rrjedhimisht, duhet të rrëzohen në bazë të rregullave 29(1), 29(3)(a) të Rregullores.

100. Në Pikat e tjera, B, C, D dhe H, ankuesit pretendojnë, përkatësisht, mungesë të mbikëqyrjes demokratike, mosrespektim të nenit 3(1) të Ligjit, tejzgjatje të procesit në gjykatë dhe mosrespektim të nenit 3(6) të Ligjit. Avokati i Popullit ka arritur në përfundimin se ankuesit nuk kanë provuar se ndonjë nga elementët e mësipërm ka shkaktuar shkeljen e të drejtës së tyre për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 14 të KNDCP-së dhe, rrjedhimisht, në bazë të rregullës 29(3)(b) të Rregullores, i rrëzon këto elemente të ankesës.

101. Për arsyet e lartpërmendura, Avokati i Popullit arrin në përfundimin se as DHSK-ja dhe as ZPS-ja nuk kanë shkelur të drejtat themelore të ankuesve.



Pietro Spera

Avokat i Popullit, Dhomat e Specializuara të Kosovës

**Më 20 shkurt 2023
Në Hagë, Holandë.**